



REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Uep. Dep.	DPK / DPKI
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Prot. No.	03-02-871/17
Data Datum	17.01.2017
PRISHTINE	

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4684/16, për zyrtarin e lartë, z. Driton Halili, Drejtor, në Telekomin e Kosovës- SH.A, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4684/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Driton Halili, Drejtor në Telekomin e Kosovës- SH.A

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë, z. Driton Halili, Drejtor në Telekomin e Kosovës- SH.A, figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Driton Halili, ka ardhur në takim dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z. Halili, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se nuk ka pasur njohuri lidhur me çështjen konflikt të interesit, dhe biznesi i cili është regjistruar nuk ka

zhvilluar aktivitet por ka theksuar se do ti marr të gjitha veprimet qe të largohet nga personi i autorizuar ne këtë biznes dhe të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit .

Me datën 11.01.2017 nga z. Driton Halili, kemi pranuar dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se në biznesin me emër "ICE KING"SH.P.K nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Driton Halili, Drejtor ne Telekomin e Kosovës- SH.A, janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

